POSTIM ARKIVOR

# Musine Kokalari (1917-1983)

Procesi gjyqësor dhe dënimi i Musine Kokalarit



SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1946 - 1983

Musine Kokalari (1917-1983) lindi në Adane, Turqi dhe u rrit në Gjirokastër e Tiranë. Studimet e kreu në Tiranë në institutin “Nana Mbretneshë” dhe në Universitetin e Romës dhe mbrojti temën e diplomës për Naim Frashërin. Me kthimin e saj në Shqipëri themeloi në vitin 1941 Partinë Social-Demokrate së bashku me Mit’hat Frashërin e të tjerë. Pas mbarimit të luftës u vendos në shënjestrën e pushtetit të ri. U arrestua menjëherë pas zgjedhjeve të dhjetorit të vitit 1945 bashkë me 36 të tjerë, sepse ishin shprehur kundër ligjit të ri elektoral dhe kishin bërë përpjekje për të shtyrë zgjedhjet e para. Musineja ishte pjesë e grupit që hartoi një notë drejtuar misionit anglez që të ndërhynte pranë Qeverisë Shqiptare të shtynte mbajtjen e zgjedhjeve të para me qëllim organizimin dhe përgatitjen e frontit opozitar përballë Frontit Demokratik. Vdiq në Rrëshen pas pas 18 vjetësh burgim e 19 vjetësh interrnim. Me vendosjen e demokracisë në vend, merr nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë titullin "Martir i Demokracisë" (1993) dhe "Nderi i Kombit" (2008). Dokumentacioni i Musinesë në dosjet e Sigurimit i përket periudhës 1945-1983, përgjatë gjithë jetës së jetuar në regjimin komunist.

SHKRIMTARJA E PARE · PARTIA SOCIAL-DEMOKRATE · OPOZITA · DISIDENCA

PERMBAJTJE #1

# Procesi gjyqësor dhe dënimi i Musine Kokalarit

Procesi gjyqësor dhe dënimi i Musine Kokalarit Në Arkivin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), për Musine Kokalarin ruhen dokumente në dy fonde kryesore: fondi hetimor-gjyqësor dhe fondi operativ. Dosja hetimore-gjyqësore nr. 10815.A-1946 lidhet me procesin e njohur të "opozitës së parë shqiptare", ku u gjykuan 37 persona, mes të cilëve Musine Kokalari, si kryetare e Grupit Social-Demokrat dhe bashkëthemeluese e organizatës "Bashkimi Demokrat". Gjyqi u zhvillua në ambientet e Kinema Nacional, nga 17 qershori 1946 deri në 2 korrik 1946. Ai u shndërrua në një ngjarje publike, duke u transmetuar përmes altoparlantëve dhe radios në të gjithë vendin. Trupi gjykues përbëhej nga major Frederik Nosi, kapiten Valedin Zeneli, Nexhat Hyseni dhe sekretari Thoma Rino, ndërsa prokuror ishte Nevzat Hazedari. Me vendimin nr. 5, datë 2 korrik 1946, Gjykata e Lartë Ushtarake e dënoi Musine Kokalarin me 20 vjet burg. Ajo vuajti 16 vjet në burgje të ndryshme dhe më pas 19 vjet internim. Dosja formulare nr. 2912 dokumenton këtë survejim të gjatë, përmes raporteve të survejimit, informacioneve të bashkëpunëtorëve, dorëshkrimeve dhe materialeve personale.

MEDIA #1

# Procesverbal

MEDIA FAQE #1



96 flet

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPRIS
GJYKATA E LARTË USHTARAKE
T i r a n ë

Nr. 5 i Librit Themelòr

96 flet

PROÇES-VERBAL

Prokurorija e kësaj Gjykate me akt-akuzën datë 10 Qershòr 1946 na deferon për gjykim, bashkë me aktet, të pandehurit: Gjergj Kokoshi, Suad Asllani, Sami Çeribashi, Qenan Dibra, Reiz Hasho, Kolë Rodhe, Lluka Bibi, Anton Dukagjini, Nesimi Starova, Hivzi Gole, Haki Gjinishi, Xhevat Miluka, Taqi Ruço, Haki Karahoxha, Ali Kavaja, Muzine Kokalari, Hasan Kalaja, Shaban Balla, Musa Dizdari, Enver Hasa, Mefail Skikuli, Qemal Biçaku, Pali Terova, Myrteza Beli, Nesti Orollogaj, Samiraz Vërlaci, Mehmet Alibeshiri, Profi Çoka, Xhahit Koka, Mahmut (Tut) Mniku, Pierin Shala, Vahid Vërdolla, Llazar Papapostoli, Niko Beça, Talat Drini, Stefan Bumçi, Abdullah Muça, që të gjithë t'akuzuar sepse janë organizuar në grupe klandestine për të përmbysur pushtetin demokratik në lidhje me kriminelat e luftës n'arrati dhe me reaksionin e jashtëm; kanë kryer dhe kanë tentuar të kryejnë vrasje kundra njerëzve dhe funksionarëve të pushtetit popullòr sidhe akte të tjera sabotazhi; u kanë dhënë informata ushtarake, politike dhe ekonomike të huajve, etj.etj., duke vepruar kështu kundra interesave të larta t'Atdheut e të popullit.

Aktet u regjistruan nën Nr.5 të Librit Themelòr të pàdinave penale të këtij vjeti dhe për ditë gjykimi të çështjes u caktua data 17 Qershòr 1946, ora 8, duke iu njoftuar të pandehurve të sipërpërmëndur që ndodhen t'arrestuar.

Tiranë, më 15 Qershòr 1946

Sekretari:
Aspirant (Thoma Rino)

Kryetari:
Major (Fredrik Nosi)

Sot, ditën dhe orën e caktuar, Trupi Gjykues i mbledhur në sallën e Kinemas "Nasional" të Tiranës, u formua nga:

Major Fredrik Nosi Kryetar,
Kapiten I-rë Veledin Zejneli Anëtar,
" Nexhat Hysejni "

Procesverbal

INFORMACION

## Procesverbal

Autoret: Trupi gjykues

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 1946 |
| STRUKTURA | Gjykata e Lartë Ushtarake |
| DOSJA | Nr. 1081.a.1 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore-gjyqësore |
| SASIA E FLETËVE | 404 |
| VITET EKSTREME | 1946 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Tiranë, Kinema "Nacional" |

| | |
|---|---|
| LIDHJA | Gjergj Kokoshi |
| GJUHA | Shqip |
| BURIMI | AIDSSH |
| KRYETAR I TRUPIT GJYKUES, (GJYKATA E LARTË USHTARAKE) | Frederik Nosi (major) |
| TRUPI GJYKUES | Veledin Zejneli, anëtar |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #3



91

30) NESIM STAROVA, bir'i Hajdarit dhe i Qerimes vjeç 39, lindur e bamues ne katundin Starove të Pogradecit, me arsim tre klasë shkollë të mesme, ish nëpunës, i martuar me kater femije, i arestuar më 15.I.1946 i denuar ne vjetin 1945 nga Gjykata Ushtarake e Korçës me 5 vjet burgim kondicional për veprimtari anti-popullore.-

31) STEFAN BUMÇI, bir'i Pjetrit dhe i Emiles, lindur më 1913 në Shkoder, banues ne Tiranë, kryer akademine ushtarake në Modena, ish oficer, i pa martuar, i pa denuar, i arestuar më 10.I.1946.-

32) NESTI OROLLOGAJ i bir'i Vangjelit dhe i Poliksenit, vjeç 47, lindur e banues në Korçë tregtar, me tre klase gjimnaz, i martuar me tre fëmijë, i pa denuar, i arestuar më 10.I.1946.-

33) PJERIN SHALA, i bir'i Nocit dhe i Maries, lindur 1920 ne Shkoder dhe banuen ne Tiranë, kryer akademine ushtarake, ish oficer, i pa martuar, i pa denuar, i arestuar më 24.I.1946.-

34) MEFAIL SKIKULI, i bir'i Jusufit dhe i Huries, lindur 1916 ne Diber te Madhe, banuen ne Tirane, kryer akademine ushtarake ne Modena t'Italise, ish oficer, i martuar, i pa denuar, i arestuar më 25.I.1946.-

35) ANDON DUKAGJINI, i bir'i Markut dhe i Prenës, vjeç 54, lindur në katundin Iball të Pukes, banues ne Tirane pesionist, i martuar, me kater femije, i pa denuar, i arestuar më 17.I.1946.-

36) MUSA DIZDARI, i bir'i Dashit dhe i Gjyles, lindur më 1913 në Pukë, banues ne Tirane profesor, me arsim te larte, i pa martuar, i pa denuar, i arestuar më 2.II.1946.-

37) SEMIRAZ VERLACI, bija e Hymer Vrionit, bashkë-shortja e Shefqet Verlacit, bija e Sanijes, lindur në Berat, e banues në Elbasan, vjeç 64, e martuar me kater femije, di shkrim e kendim, e pa denuar, pronare, e arestuar më 5.II.1946.-

Të përfaqësuar :

Shaban Balla, Profi Çoka, Mehmet Ali Beshiri, Musa Dizdari, Xhevat Miluk. AVOKAT Z. SPIRO STRINGA .-

Suad Asllani, Reiz Hasho, Llazar Papapostoli, Lluk Bibi, Vehid Verdova, Stefan Bumçi, Hasan Kalaja e Qemal Biçaku, AVOKAT Z. EFTHIM CANCO.

Ali Kavaja, Pali Terova, Haki Gjinishi e Mefail Skikuli, AVOKAT Z. FERIT ÇABEJ.

Hivzi Golja, Sami Çeribashi, Myrteza Beli, Nesim Starova e Pjerin Shala, AVOKAT Z. VASIL XHAJA.

Haki Karahoxha, Enver Hasa, Mahmut ( Tut ) Mëniku, Talat Drini, Niko Beça, e Taqi Ruço, AVOKAT Z. VASIL BIDOSHI.-

Abdulla Muça, Xhahit Koka, Qenam Dibra, Andon Dukagjini, Nesti Orollogaj, Semiramiz Verlaci, e Kol Rodhe, AVOKAT Z. ARISTIDH TOTOZANI.-

Musine Kokolari dhe Gjergj Kokoshi, refuzuan avokatët mbrojtësa tue marë përsipër ata vete mbrojtjen e tyre.

T' a k u z u a r :

Sipas akt-akuzave të Prokurorit si armiq të popullit, dhe sabotatorë të pushtetit ne baze te Nenit 15 te Ligjes Nr. 41 date 14. Janar - 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake dhe Nenit 1 të Ligjes Nr. 21 date 15 Dhjetor 1944 mbi sabotatoret e luftes dhe të pushtetit.

G j y k a t a :

Mbasi shqyrtoi akt-akuzat e Prokurorit ;

Pasi shqyrtoi proces-verbalet e mbajtura nga organet e mbrojtjes popullit;

Pasi ndigjoi apollogjinë e të pandehurve;

Pasi shqyrtoi dokumentat qe vertetojne akuzat e të pandehurve;

Pasi ndigjoi deponimet e deshmimtarve t'akuzes dhe gjithe dëshmimtarve të tjerë të banum me betim para gjyqit;

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #4



Pasi ndigjoj pretencën e Prokurorit ;

Pasi ndigjoj mbrojtimet e avukatëve ;

Pasi ndigjoj fjalën e fundit të sej cilit të pandehur;

Pasi studioj të gjitha dokumentat e tjera të ndodhura në dosjen e tyre;

Pasi studioj dhe mejtoj çashtjen ne fakt e ne të drejtë:

K o n s t a t o n :

Prokuroria dhe zhvillimi i gjyqit nxori ne shesh se: Fill mbas çlirimit të Shqipërisë, gjith mbeturinat fashiste ne vendin t'one ( ball, legalitet, kuislinga, çifligare të mbëdhenj, tregëtare, spekullante, mercenare, vegla te ndergjegjeshme t'okuptorve) të shpartalluar fund e krye nga ngadhnimi i luftes se madhe çlirimtare te popullit Shqiptar, të dizorientuar ne fillim, ma von nisin te levizin e të rigrumbullohen për me vazhdue trathtine e vjeter. Bujaria dhe zemër gjeresia e popullit nuk i preki aspak zemrat e ktyre kriminelve e ktyre njerzëve të degjeneruar. Indulgjencën e popullit e morën për dobësi.

Ç'prej Janarit 1945 (ndersa populli Shqiptar i ishte për veshur betejescsë madhe të rindertimit) Shaban Balla, kerkon nga Hivzi Golja nji liste të kriminelve t'aratisur në rajonin e Peshkupise: Hysni Dema, Fiqri Dineja, Muharem Bajraktari, tre nga kokat ma të mbëdhaja të trathtisë jane dhe shtylla vertebrale ku do mbeshtetet ma von i ashtu quajturi " Grupi i Rezistencës". Kjo bande kriminelësh nga Prilli 1945 e përbame prej: Sami Çeribashit, Hivzi Goles, Ali Kavajës, Shaban Ballës, Andon Dukagjinit, Profi Çokës dhe Haki Gjinishit arine të kristalizohet tue u mbi emnuar, " KOMITETE NASIONALIST INISJATOR ". Veprimatria e pare e tyre asht me u lidhur me një anë me agjentet të reaksionit te jashtem ( Oficer të huaj ) dhe nga ana tjeter me kriminelét e luftes t'aratisur ne Shqipëri e jashte. Tregëtari spekulant Profi Çoka, përveç pjes marjes tij aktive ne kte bandë kriminale qe kishte për qëllim me përmbysur Pushtetitn Popullor me violence, interesohesh ne radhe te pare dhe me i shpëtue tatim fitimit te drejte vuemun atij. Për kete qellim me anë e Shaban Balles, nderlidhesi i grupit me Oficeret e huaj, mbasi përpillon nje note nemër të 10 a 15 tregetarve te tjere spekulante të tatuar, Prof Çoka ja dorezon kte note të huajve.

Të gjithe kta armiq te popullit mbeshtetjen e tyre e kishin te kriminelet e luftes t'aratisur mbrenda dhe jasht Shqipërisë, çifligaret, e mbedhenj, tregetaret spekulantë, familjet e kriminelve te luftes, pseudo-intelektuakëve që: aspiroshin me aritur pozita, ish elementëve dhe oficerëve të Ballit, Legalitetit të cilët bashkëpunuan deri në çlirimin e Shqipërisë me okupatorët. ( Shembulla nga te fundit në ktë proçes janë: Musine Kokolari, Mehmet Beshiri, Xhahit Koka, Qenam Dibra, Tut Mëniku,

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #5


-- 161 --

Nefail Skikuli, Lluka Bibi, Enver Hasa, Stefan Bumçi, Hivzi Golja e Hasan Kalaja, -të gjithe kta elementë gjate luftes çlirimtare kane bashkepunuar me okupatorët.

Ne baze te nji plani të përcaktuar ky grup trathtar e terorist në takimin e pare në shtepine e Shaban Balles me Nënkolonelin Palmer, ndermjet të eksponentit të tij Sami Çeribashit, mbasi e paraqet ngjendjen ne Shqipëri si kaotike, të vajtushme, ne kundershtim flagranet me realitetin, kërkon ndihmën materiale ( armë, municion, të holla nderhyrje ushtarake direkte, sigurime se nga ana e reaksionit Grek e nderkombetar do kishte përkrahje të plotë) dhe ndima morale (propogandë shifje ne dëm të popullit Shqiptar me ane te radios, shtypit, dhe ç'do mjeti tjeter të përshtatshëm) për me përbysur pushtetin popullor me violencë. Hapi tjeter me rendesi asht lidhja e regullt me kriminelet e luftes me ane të leter thirjeve ( te shkrojtura me maqine nga Hasan Kalaja ) për me bashkepunue me ta për realizimin e planeve kriminale: 1) përbysjen e pushtetit popullor, kthimin e regjimeve shtypëse të së kaluarës; 2) dhe konçesioneve toritoriale atyre qe lakmojne tokatbt'ona (Reaksionit Grek, ku Sami Çeribashi në lidhje me tre (3) Bataljonet dhe bandat trathtare të kriminelit të luftes - masakratorit të Çamëve-Haki Rushitisot i strehuar ne Greqin e reaksionit ) 3) kontakti me kriminelet e luftes t'aratisur Hysni Dema, Fiqri Dinen, Muharem Bajraktarin u bë efektivisht me ndermjetësine e antarit shumë te zellshem te bandes kriminale Hivzi Golja ( letrat e shumta qe ka mare dhe i ka derguar ky i fundit Hysni Demës me Shokë u pranua plotësisht) Hivzi Golja mori përsipër me utakue personalisht me Xhelatin e kater shkurtit 1944, dhe me gjithse Hivziu mohon t'a ket takuar, ai qendroj në Peshkupi 6 gjashte dit për atë qëllim. Kriminelet e luftes t'aratisur u ftuan qe te mernin pjese me nji të ashtu quajtur Kongres te tyre qe do të mbahesh më 7 shtate Nandor 1945. Ky grumbullim deshtoj pamvaresisht nga vullneti i tyre. Ndjekja dhe kapja e kriminelve te luftes t'aratisur nga dora e popullit qe e madhe dhe kjo pengoj ardhjen e tyre. Grupi i Sami Çeribashit përveç ndihmave materiale ne te holla e veshmbathje i dergoj kriminelve dhe direktiva, udhezime, shpresa për t'ardhmen dhe lehtesoj ardhjen e tyre ne kontakt me reaksionin e jashtem ( 2 Oficerat qe Hysni Dema dërgoj në Greqi me u marun vesh me reaksionin Grek). Në mënyre më konkrete grupi Sami Çeribashit, reth të cilit vertiteshin d dhe Qemal Biçaku, Haki Karaoxha, Tut Mëniku, Semiraz Verlaci, ka patur lidhje te rregullta me kriminelet e aratisur ne krahinen e Shkodres -

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #6


-- 162 --

Pashuk Biben, Mark Gjon Markun, Llesh Marashin etj. Kjo lidhje u provua me ane te Frano Mirakajt, nderlidhesat të grupeve teroriste te Shkodres me ato te Tiranes, i cili shpjegoj kjartazi para gjyqit ktë lidhje, "Kryengritja" tha ai, " do fillonte ne Shkoder nga ana e kriminelve t'aratisur kur te vinte direktiva nga Komiteti Tiranes (D;m.th. grupi terorist i Sami Çeribashit)." Ne rethin e Shkodres jane banum nje seri vrasje nga ana e krimineleve t'ratisur, si ajo e përgjegjësit të arsimit në Mirditë, Prenk Ndue ne baze te nji pllani të koordinuar antetatesh kunder njerezve te Pushtetit, si ajo e përgjegjësit të Rinis ne Kruje Qemal Veseli, ajo e përgjegjësit të Komitetit Ekzekutiv të N/Prefektures Kurveleshit Selman Lame, e 1) Rustem Daka, 2) Liman Laçi, 3) Qazim Peqini nga krimineli aratisur Vlash Arapi ( me te cilen esht takuar Ali Kavja). Për të gjitha këto vrasje përgjegjësija morale bije mbi këto grupe teroriste - pse kto janë frymëzuesit dhe udhezuesit e kriminelve te luftes t'aratisur te cilet enkuruajuar nga ndimat morale e materiale të shokëve te tyre besnik në Qytet dalin nga strofullat e tyre dhe behen agresiv si Laje Nuroja ne Vlorë, ne trupin e te cilit gjendet letra e Abdulla Kreshpës. Kjo leter provon lidhjet e ngushta qe kane këta terorista me ta." Te jap sihariqin e math...............se në Tirane paska kohe qe nje Komitet qendror i përbere nga njerzish më të shënuar e të famshëm për veprimtarinë e tyre patriotike............ky asht Komiteti Qendror qe ka vepruar rrugen e tij ne vise te bdryshme të Shqipërisë, si në Tirane, Elbasan, Diber, Shkoder e tj..........Çashtje e jote u rapurtua ne Tirane d.m;th. në Qendror dhe mbas disa vrejtjeve qe te jane hequr për gabimet e tua në të kaluaren, më në fund u vendos qe t'i të quhesh një antar'i lëvizjes dhe qe sot e tutje të vihesh ne dispozicion te saj. Qëndrori e caktoj dhe ktu ne Vlorë degen e tij nga e cila ti do ti marish te gjitha direktiva dhe instruksionet."

Letër-thirrjet për kriminelat e luftës t'arratisur përpilohen e shpërndahen në këtë mënyrë: tri copë Ali Kavaja, pesë copë Anton Dukagjini dhe të tjerat Hivzi Golja, për t'i shpërndarë respektivisht në Shqiprinë e Mesme, në Shkodër e në Dibër. Letër-thirrjet u shpërndanë në rregull dhe lidhjet u vendosën me 'ta.

Prova asht: tre takime në Krrabë me ish-majorin e Gestapos, xhelatin e popullit t'Elbasanit, Alush Leshanakun; në këto takime ku shtrohen plane për vepra terroriste e sabotazhi kundra popullit dhe pushtetit, marin pjesë aktive Ali Kavaja, Tut Mëniku, Qemal Biçaku, Haki Gjinishi dhe Haki Karahoxha. Alush Leshanaku, i trëmbur

./.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #7





93

nga hakmarja e popullit, kërkon ndihmë me kalue në Greqi për me shpëtue kokën, por këta e nxisin me vazhdue veprimtarinë e tij kriminale, tue i dhanë shpresa e drejtime për çfarëdolloj ndihmash. Mburren me 'të dhe e përgëzojnë për të kaluarën e për çka do të bajë. Bajnë plane me e përdorë atë për me sulmue depo ushtarake në Librazhd e gjetkë e për me zbrazun pushkë ditën e votime, 2 Dhjetòr 1945. Me anën e Semiraz Vërlacit, e ndihmojnë atë të lidhet me kriminelin e arratisur në Greqi Shevqet Vërlacin, patron i tij i dikurshëm.

Ali Kavaja, gjithëmonë n'emër të Grupit terrorist, takohet edhe me kriminelin Vlash Arapin në rrethet e Kavajës, ku Aliu e lidh këtë me nënkomitetin e grupit terrorist që Aliu shkoi e ngrehu në Kavajë. Ngrehja e degëve të kësaj bande terroriste ~~edhe~~ nëpër qarqe ishte në planin e saj. Dhe në disa qarqe, nga puna e tyre e palodhur, arrijtën të formohen. Sami Çeribashi me shokët e tij lidhen me grupin terrorist të Korçës, me anën e delegatëve t'ardhur apostafat në Tiranë, Myrteza Beli e Nesti Orollogaj. Grupi i Korçës, i përbërë nga dy të përmëndurit dhe nga Llukë Bibi, Nesim Starova, Pal Terova, Vahid Vërdova, kishte si organizues e frymëzues Kolë Rodhen, i cili gjatë zhvillimit të proçesit dolli dhe organizues e frymëzues, me anën e Ali Selenicës, të një grupi terrorist tjatër në Kolonjë. Terroristave të Korçës, Sami Çeribashi me shokët e tij u japin udhëzime dhe ndihma materiale, njëkohësisht direktiva për me u lidhun me reaksionin grek. Për këtë punë ngarkohet Nesim Starova, i cili ka marë dy napolona ar nga Nesti Orollogaj dhe 5.000 Fr.Shq. nga Hivzi Golja. Ky i ligështuem, veprën kriminale të nisur e lën në tentativë dhe nuk e kryen ndërlidhjen e dëshëruar. Kjo ndërlidhje kryhet me mënyra të tjera. Grupi terrorist i Sami Çeribashit sidhe të gjithë të pandehurit e tjerë, kanë pritur, uruar e punuar për një ndërhyrje t'armatosur nga reaksioni grek, ndërhyrje që do të kishte si pasojë nënshtrimin e Atdheut t'onë ndaj njëj zgjedhe të huaj. Dhe kjo asht tradhëti e naltë kundrejt Atdheut. Për këtë arësye të gjithë këta së bashku mejtonin e punonin si Prof Çoka: "S'na duhet ushtërija, duhet çmobilizuar ushtërija." Disa nga këta, si Prof Çoka, Shaban Balla, u kanë dhanë informata me karakter ushtarak dhe ekonomik të huajve

../.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #8





në dam t'interesave t'Atdheut.

Sami Çeribashi asht shpirti i lëvizjes së këtij grupi. Punon pa u lodhur për të shtuar radhët e kompllotistave terroristë të tij. Hotelin "Dodge" në Durrës e bën çerdhe veprimtarije. Kur dyshon se Hasan Kalaja në takime rasti me njerëz të Lëvizjes mund të zbulojë të fshehtat, i thotë këtij se në hotel edhe kamarierët i ka zgjedhur si vehten e tij, besnikë të tradhëtis. Përpara Majorit Arnof, Sami Çeribashi mburret për vrasjen e përgjegjësit të rinis në Krujë, shokut Qemal Vejseli, si vepër e grupit terrorist të tij, tue premtue edhe vepra të tilla ma të mdhaja. Para Gjyqit të Popullit, në një çast sinqeriteti ngrihet e pohon dramatikisht: "Që të gjithë nè, pa eksepsion: Musine Kokalari, Suad Asllani, Gjergj Kokoshi, unë e tërë grupet e tjerë terroriste, vetëm një qëllim kishim: të rrëzonim pushtetin popullòr me violencë, me mitroloza në dorë, me ndihmën e kriminelave të luftës t'arratisur dhe me atë të reaksionit të jashtëm."

Paralelisht me lindjen e rritjen e grupit terrorist të Sami Çeribashit, lindet e rritet edhe grupi terrorist i njerëzve t'ish-organizatës tradhëtare të Legalitetit ku çquhen si koka dirizhuese, si organizatorë, inisiatorë dhe ekzekutorë: Qenan Dibra, Xhahit Koka, Abdullah Muça, Mehmetali Beshiri, Reis Hasho, Tut Mëniku, Talat Drini, etjerë. Të gjithë këta vazhdojnë punën tradhëtarë aty ku e la Abas Kupi e Mehdi Frashëri. Fill mbas çlirimit të Shqipris, këta njerëz, tue abuzue nga shpirtmadhësija e pushtetit popullòr, i cili me gjithëse fajtorët i la të lirë, rigrumbullojnë radhët e tyre dhe n'errësirën e natës mbrehin thikat me ia ngulun popullit mbas shpine. Organizojnë dhe veprojnë për përmbysjen e pushtetit popullòr me anën të kriminelave të luftës, me anën t'atentateve, me anën të sabotazhave dhe me anën e një ndërhyrjes s'armatosur nga jashtë. Të njajtat qëllime të poshtra i bajnë që ma vonë të bashkohen e të shkrihen me grupet e tjerë terroristë. Qenan Dibra e Xhahit Koka, dy organizatorët më të çquar të këtij grupit tjetër terorist, nuk mjaftuan me punën tadhëtare që bënë për llogari t'organizatës mercenare të Legalitetit, por nga Prilli i vjetit 1945 formojnë grupin e tyre

../.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #9



-- 186 --

thërret i ekzaltuar: "ky ësht një sihariq i madh për nè". Shevqet Vërlaci asht autòr i 7 Prillit 1939. Shevqet Vërlaci mund të bahet prapë autòr i një 7 Prilli të dytë. Historija e tradhëtis bahet e papërsëritshme me eliminimin e atyreve q'e shkruajnë.

Lidhur ngushtë me grupin terrorist-monarqist të Qendrës, dhe nën direktivat e tij, punon grupi i ish-oficerave dhe i elementave mercenarë të Legalitetit: Nefail Skikuli, Enver Hasa, Stefan Bumçi, Talat Drini, Mehmetali Beshiri, Mahmut Mëniku. Kafeja "Splendid" asht vënd-mbledhja ma e preferueshme e tyre. Me cinizmën ma të madhe para popullit punëtòr që kalon aty pari, këta njerëz thurin plane se si me i bamun varrin popullit q'i ka toleruar me rrojtun në mes tyre, me bujarinë q'e karakterizon.

Nën direktivat e Metali Beshirit, ish sekretar i I-rë i Zogut, Kryetar i një lagjeje në Tiranë për Legalitetin, pjesëmarës në luftimet kundra partizanëve në Pezë e në Tujan, Enver Hasa pregatit një ekspozè për të huajt, relasion plotë me shprehje e gënjeshtra për situatën e Shqipris, dhe ku kërkohet ndërhyrja e të huajve për me skällavërue popullin shqiptàr, dhe në radhë të parë çmobilizimi i Ushtëris heroike Nacional-Çlirimtare. Kjo ushtëri glorioze që u theu dhambët okupatorëve e tradhëtarëve e që sot asht mburoja e çelnikët e Atdheut, asht tmerri i këtyre armiqve të betuar të popullit shqiptar. Çdo,vepër e tyre synon çkatërrimin e saj; por kjo Ushtëri e lavdishme ësht e pathyeshme pse asht Ushtëri e popullit dhe faktòr paqeje në Ballkan.

Relasioni kriminal që përpilohet me shërbye si një thikë në shpinë t'Atdheut, bashkë me një listë prej 1200 emërash që do të shërbente si mbështetje për grumbullim elementash të pakënaqur, iu dorëzue të huajve.

Qenan Dibra, Xhahit Koka, Sami Çeribashi e shokët e tyre bahen copash me ba takime me gazetarët të huaj, të cilëve u paraqesin gjendjen e Shqipris t'errët e kaotike, ku mbretëron terrori. Si pasojë, këta armiq të popullit bajnë çmos për me pengue njohjen e të drejtave të shumta të popullit shqiptar nga bota e jashtëme.

Njohja e Qeveris demokratike Shqiptare më 10 Nëndòr 1945 shkakton panik e pikëllim në zëmrat e tyre.

Talat Drini, në bashkëpunim me armiq të tjerë të popullit, tue veprue nën udhëzimet e kriminelave të luftës në Itali ku asht

./.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #10



-- 185 -- 94

nga mbledhjet qe bajne te mulliri Abdullah Muços ku janë prezent përveç këtyre të treve dhe : Reis Hasho, ish Oficeri zogist, sherbetor'i okupatorit deri në çporjen e tij nga vendi jonë, Enver Hasën dhe Kiço Zhongën, i cili ishte i destinue me bamun ndërlidhjen me reaksionin grek, të njajtën punë që bani Mit-hat Frashëri gjatë okupasionit tue dergue Dhimitër Fallon ne Selanik. Ktu mund të thuhet me vënd se përsëritet historija e vjetër e trathëtisë. Nga kto mbledhje klandestine del e njajta punë: lidhje me kriminelët e luftes dhe ajo me reaksionin ndëkombëtar për me përmbysur Pushtetin me violencë.

Me ndërmjetësinë e një agjentit të huaj, Llazar Papapostolit, ky grup terrorist, i mbiquajtur monarqist, mer kontakt me oficera të huaj në shtëpinë e Abdullah Muçës, ku ndodhen prezentë përveç të zotëve të shtëpis, edhe Qenan Dibra, Llazar Papapostoli, N/Koloneli Palmer dhe Majori Smith. Qenan Dibra ekspozon gjendjen në Shqipri në mënyrë krejt të ndryshme nga realiteti dhe kërkon ndihma materiale e morale nga të huajt për të përmbysur pushtetin popullòr. Këto ndihma do të kunorëzohëshin me një ndërhyrje ushtarake të jashtëme. Dhe këtu përsëritet e vjetër e tradhëtis. Pregatiten dhe shtrojnë pllane për një 7 Prill 1939 të dytë: kulmi i tradhëtis.- Flitet për ndërhyrjen e reaksionit grek e ndërkombtar dhe për lidhjet me kriminelat e luftës, prezentë gjithëmonë në çdo bisedë, përeanje e hapët që bëjnë këto grupe terroriste. Këtu ësht me vënd pohimi i Nefail Skikulit, para gjyqit "në qoftë se më lejohet shprehja, grupet t'ona terroriste bajshin garë se kush të rekrutonte ma shumë kriminela lufte" Të gjithë këta terroristë mburrëshin me Hysni Demën dhe xhelatët e mbëdhenj të popullit shqiptar. Deri në këtë pikë arrijti depravacioni moral i këtyre njerëzve. Nefail Skikuli organizon një mbledhje në shtëpinë e Enver Hasës në Qershòr 1945 ku mernin pjesë: Qenan Dibra, Mehmet Beshiri, Tut Mëniku, Nikolla Kotte, Enver Hasa e Nefail Skikuli, ku këndohen si kurani ose ungjilli fjalët e shkrojtura nga kriminelat e arratisur Hysni Dema, Shemsi Hatibi, Aziz Biçaku (plagosësi i Gjeneralit Englez Davies) dhe të tjerëve që nuk u dihen emërat. Po kjo gja ndodh edhe në grupin terrorist të Sami Çeribashit, kur Hivzi Golja bjè letrat e Hysni Demës. Këto letra shkaktojnë gëzim dhe enthusiazmë. Kur Shaban Balla bje lajmin e arrijtjes së letrës së Shevqet Vërlacit tek Niko Beça, dhe kur këndohet fraza "së shpejti do të jemi në Shqiprì",

./.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #11

95

takue edhe me vëllaun Hamza Drini, pregatit një plan se si me shpëtue nga burgu tre nga krerët ma të mbëdhenj të tradhëtis: regjentët kuislingë Patër Anton Harapin, Lef Nosin dhe kryeministrin kuisling Maliq Bushatin. Në këtë mënyrë banda kriminale e Talat Drinit donte me o çkëputun Drejtësis së Popullit tre tradhëtarë të mbëdhenj. Gjithashtu ay në bashkëpunim me dirizhuesit e tij Qenan Dibra e Xhahit Koka, përpiloi një trakt fashist me u fol ose hedhun ditën e 28 Nëndorit 1945 për me mbjellun përçarje dhe urrejtje në popull.

Gjergj Kokoshi, tue përfitue nga pozita e tij zyrtare në pushtet e në Frontin Demokratik, spekulloi në mënyrë të turpshme tue tradhëtue interesat e nalta t'Atdheut e të popullit. Në bashkëpunim të ngushtë me Suat Asllanin, ky punoi me dinakëri për me shkaktue përçarje në rreshtat e Frontit dhe për me minue pushtetin popullòr. Opozita e tij kundër votimit të ligjës elektorale që u zbulua nga zhvillimi i gjyqit u provua se ishte e pasinqertë dhe hipokrite. Në rrethe konfidenciale dhe konfesione që bëri në të huajt, Gjergj Kokoshi tregoi qëllimet e tij të vërtetë, që ishin me përmbysun pushtetin me violencë, tue thanë, "unë e kundërshtova ligjën elektorale pse kishte të meta, mbassi ay ishte perfekt, por pse desha me gjet një pretekst për me u tërhekun nga Fronti". Gjergj Kokoshi, fill mbas këtij kundërshtimi, u ba personi ma i dashur për reaksionin në Shqipri dhe për agjentët e reaksionit të jashtëm. Bashkë me shokun e tij të pandarë, avokatin hipokrit, pseudo-demokrat, Suat Asllanin, Gjergj Kokoshi, ma konkretisht dolli në sqenë si katalizatori i gjithë grupeve terroriste në Shqipri. Në mbledhjet te shtëpija e Shaban Ballës, në Nëndòr 1945, ku marin pjesë krerët e të tre grupeve terroriste, t'ashtuquajtur Rezistencë, Monarqist e Social-Demokrat, Gjergj Kokoshi del në skenë si bajraktar i tyre. Vet para gjyqit pohoi se "kishte pranuar me i kryesue këta grupe por me një kusht". Gjergj Kokoshi kishte dijeni të plotë se gjithë këto grupe ishin lidhur me kriminelat e luftës. Ay vet pohoi se pranonte me i ndihmue familjet e tyre, si atë të Hysni Demës. Gjergj Kokoshi edhe para Gjyqit të Popullit qëndroi i patundur në tradhëtinë e tij karshi popullit. Kjo què një provë tjatër bindëse për Trupin Gjykues për fajsinë e tij. Ay nuk tregoi asnjë shënjë pendimi si shumica dërmuese e 37 të pandehurve. Ay jo vetëm se

./.

AIDSSH Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #12



u mundue të mbulojë tradhëtinë e tij me demagogji dhe strategjema si ajo e emnimit të një komisioni me hetue çështjen e tij, gjë në kundërshtim me ligjët shtetnore në fuqi, por ay u ba mbrojtës i tradhëtis të të gjithë të pandehurve. Gjergj Kokoshi qëndron armik i betuar i popullit deri në fund.

Me gjithëse Suad Asllani, bashkëpunëtòr i pandarë i Gjergj Kokoshit, në dirizhimin e grupeve terroriste, u mundua të mohojë gjithëçka me mjeshtri profesionale, që tek ay asht bamun aberasion profesional, Gjykata e provoi plotësisht pjesëmarjen e tij aktive në këto grupe si organizatòr e drejtues, me anë të dokumentave, me anë të dëshmitarëve, atribuimet e të pandehurve dhe solli bindje të plotë në fajsinë e tij. "Po t'organizoheni, të hiqni dorë nga divergjencat, kini me vehte edhe Suat Asllanin si drejtues" i thotë Dilaver Asllani Mehmet Beshirit, një nga eksponentët e grupeve terroriste.

Në biseda të ndryshme me Musine Kokalarin, Gjergj Kokoshin, Shaban Ballën, Sami Çeribashin, Muhamet Hoxhën, oficera të huaj, Suat Asllani paraqitet si person që ka dijeni të plotë për ekzistencën dhe pjesëmarjen e tij në grupe terroriste për përmbysjen e pushtetit me violencë. Musine Kokalarit, ndër të tjera ay i ka propozuar edhe redaksinë e një gazete ilegale kundra pushtetit që do të financohej nga një burim i ditur vetëm nga ay. Ka dijeni mbi përpilimin e notave çpifëse dorëzuar të huajve. Një nga atö e ka firmuar me ndërmjetësinë e Gjergj Kokoshit. Mohimi i tij i vazhduarshëm para gjithë provave që i solli Gjykata ia forcoi bindjen kësaj së fundit se ay asht ma fajtòr se sa duket. Mohimi i tij nuk e trondit aspakë të vërtetën, mbassi gënjeshtra tek ay asht bamun sistem. Ka qënë në bashkëpunim të ngushtë me Musine Kokalarin, kryetare e Grupit terrorist të mbiemnuar Social-Demokrat.

Musine Kokalari ka dirizhuar aktivitetin e gruas balliste gjatë okupasionit, tue bashkëunuar ngushtësisht me krerët tradhëtarë të Ballit, Mid'hat Frashërin, Ali Këlcyrën, Skënder Muçon, etjerë. Ka nxjerë organin tradhëtarë gjoja Social-Demokrat "Zëri i Liris" ku luftëtarët e liris thyhëshin e përmëndëshin me përbuzje dhe ku ekzaltohësh tradhëtija e Ballit. Këtë aktivitet të gjerë të saj dhe në dam të madh të luftës çlirimtare, Musineja e vazhdoi edhe mbas çli-

./.

AIDSSH Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #13

-- 189 --

96

rimit të Shqipris egërsisht. Zëmra e saj asht e mbushur me urrejtje për fitoret e mbëdha të popullit. Organizon grupe të rinjsh të cilët i helmatos me propagandën e saj të vjetër balliste. Gjithëçka ndryshoi në vëndin e jonë ku ka lindur një jetë e re, vetëm në shpirtin djallëzòr të Musines vlon fryma hakmarëse dhe urrejtja kundër popullit. Nën maskën e Social-Demokracis, kjo grua zhvillon një aktivitet të gjerë kriminal e terrorist, tue mashtrue me dyzina të rinjsh. Me anën e bashkëpunëtorit të saj të vjetër, pseudo-intelektualit si vehtja e saj, Musa Dizdarit, kjo lidhet me kriminelat e luftës dhe grupet terroriste të Shkodrës. Pjetër Gila nga Shkodra, korrier i grupeve terroriste atje, i tregon aktivitetin e gjerë që zhvillohet atje dhe kjo i thotë se "edhe ne këndej po punojmë", "dhe ne këndej jemi të lidhur me kriminelat e luftës t'arratisur". Pagëzon grupin terrorist të Sami Çeribashit "Grupi i Rezistencës" se për Muzinen populli asht okupatòr që duhet çliruar për me u futun në zgjedhën e krerëve të tradhëtis, ish miqtë e saj të ngushtë përtej Adriatikut. Përpilon nota çpifëse për Atdheun e saj dhe pranon që këto nota t'u dorëzohen të huajve. Lidh mbas qerres së saj të tradhtis Musa Dizdarin dhe një grup të rinjsh, të cilët janë krejtësisht viktimat e saja.

Musa Dizdari pranon me bashkëpunue me Musine Kokalarin për me përmbysun pushtetin me violencë. Asht koshient i veprës së tij dhe me vullnetin e tij të lirë firmon nota diskredituese për popullin shqiptar dhe luftën e tij, nota të cilat u dorëzohen të huajve. Edhe kur përplaset në fytyrë e vërteta nga dëshmitari Pjetër Gila dhe e pandehura Musine Kokalari, ky vazhdon me mohue në mënyrë qesharake. Ky qëndrim i tij e bind trupin Gjykues më shumë mbi fajsinë e tij.

Llazar Papapostoli mer pjesë në shumë mbledhje tue aprovue planet që shtrohen atje për me përmbysun pushtetin popullòr me violencë. Pranon të bahet ndërlidhës ndërmjet grupit terrorist të Qenan Dibrës dhe oficerave të huaj reaksionarë. Firmon e përkthen nota drejtue të huajve dhe kundër interesave të naltat'Atdheut.

Nikolla Beça ban shtëpinë e tij çerdhe për mbledhjen e grupeve terroriste ku mer pjesë edhe ay vet. Lidhet me kriminelat e arratisur (Shevqet Vërlacin dhe Alush Leshanakun). Pranon të fshehë

./.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #14

-- 189 --

96

rimit të Shqipris egërsisht. Zëmra e saj asht e mbushur me urrejtje për fitoret e mbëdha të popullit. Organizon grupe të rinjsh të cilët i helmatos me propagandën e saj të vjetër balliste. Gjithëçka ndryshoi në vëndin e jonë ku ka lindur një jetë e re, vetëm në shpirtin djallëzòr të Musines vlon fryma hakmarëse dhe urrejtja kundër popullit. Nën maskën e Social-Demokracis, kjo grua zhvillon një aktivitet të gjerë kriminal e terrorist, tue mashtrue me dyzina të rinjsh. Me anën e bashkëpunëtorit të saj të vjetër, pseudo-intelektualit si vehtja e saj, Musa Dizdarit, kjo lidhet me kriminelat e luftës dhe grupet terroriste të Shkodrës. Pjetër Gila nga Shkodra, korrier i grupeve terroriste atje, i tregon aktivitetin e gjerë që zhvillohet atje dhe kjo i thotë se "edhe ne këndej po punojmë", "dhe ne këndej jemi të lidhur me kriminelat e luftës t'arratisur". Pagëzon grupin terrorist të Sami Çeribashit "Grupi i Rezistencës" se për Muzinen populli asht okupatòr që duhet çliruar për me u futun në zgjedhën e krerëve të tradhëtis, ish miqtë e saj të ngushtë përtej Adriatikut. Përpilon nota çpifëse për Atdheun e saj dhe pranon që këto nota t'u dorëzohen të huajve. Lidh mbas qerres së saj të tradhtis Musa Dizdarin dhe një grup të rinjsh, të cilët janë krejtësisht viktimat e saja.

Musa Dizdari pranon me bashkëpunue me Musine Kokalarin për me përmbysun pushtetin me violencë. Asht koshient i veprës së tij dhe me vullnetin e tij të lirë firmon nota diskredituese për popullin shqiptar dhe luftën e tij, nota të cilat u dorëzohen të huajve. Edhe kur përplaset në fytyrë e vërteta nga dëshmitari Pjetër Gila dhe e pandehura Musine Kokalari, ky vazhdon me mohue në mënyrë qesharake. Ky qëndrim i tij e bind trupin Gjykues më shumë mbi fajsinë e tij.

Llazar Papapostoli mer pjesë në shumë mbledhje tue aprovue planet që shtrohen atje për me përmbysun pushtetin popullòr me violencë. Pranon të bahet ndërlidhës ndërmjet grupit terrorist të Qenan Dibrës dhe oficerave të huaj reaksionarë. Firmon e përkthen nota drejtue të huajve dhe kundër interesave të naltat'Atdheut.

Nikolla Beça ban shtëpinë e tij çerdhe për mbledhjen e grupeve terroriste ku mer pjesë edhe ay vet. Lidhet me kriminelat e arratisur (Shevqet Vërlacin dhe Alush Leshanakun). Pranon të fshehë

./.

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

MEDIA FAQE #15



-- 191 --

92

nga faktet deliktuoze q'u ngarkohen te pandehurvet,nga akuza publike', vetem se behet nje tentative qe veprimtarise kriminale te te pandehurvet t'i atribuhohet nje randesi e vogel.Kjo tentative jo e ndershme nga ana e mbrojtjes,perveç qe asht ne kundershtim me te verteten,pse si pasoje e veprave te te pandehurve kemi ne Shqiperi nje seri atentatesh terroriste te konsumueme,si ne Shkoder,Kruje,Kavaje,Kurvalesh e gjetiu,te permendura veçanrisht,pergjegjesia morale e te cilave bjen kryekeput kolektivisht mbi grupet terroriste;por nga ana tjeter mohohen damet dhe vuajtjet e patregueme qe do t'i shkatoheshin popullit Shqiptar sikur vepra kriminale e te pandehurvet te realizohej.Prandaj mbrojtjet e avokateve ne pergjithesi s'kane baza ligjore dhe si te tilla nuk mund te sostenohen me seriozitet dhe kjo mbrojtje asht e pa vlefshme per me ndihmue Trupin Gjykues ne percaktimin(vleftesimin) e se vertetes dhe n'administrimin e ndeshkimeve.-

Gjykata e Popullit asht e bindun se tradhetija e nalte kundrejt Atdheut dhe popullit asht krimi ma i madh qe mund t'ekzistoje dhe si i tille duhet ndeshkue rande.-

P r a n d a j,

Gjykata,per aresyenat e siperme dhe ato qe do te shenohen per sejcilin ne pjesen anekse te ketij vendimi,ne baze te neneve 3,15 e 18 te Ligjes Nr.41 date 14 Janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake dhe te nenit 1 te Ligjes Nr.21 date 15 Dhjetor 1944 mbi sabotatoret e luftes e te pushtetit,pjeserisht te nje mejtimi me Prokurorin dhe pjeserisht ne kundershtim me kerkimin e tij,

V E N D O S I:

Fajtorine e te pandehurve,cilesimin e tyre si armiq te popullit dhe sabotatore te pushtetit dhe ndeshkimin e tyre si vijon:

1) SAMI ÇERIBASHI,SHABAN BALLA,QENAN DIBRA,XHAHIT KOKA,HIVZI GOLJA,ALI KAVAJA,MEHMETALI BESHIRI?TALAT DRINI,MAHMUT MENIKU- me vdekje,humbjen e te drejtave civile e politike dhe konfiskimin e pasurise se tyne te lujteshme e te palujteshme ne konformitet me dispozitat ligjore ne fuqi;

2) PROF ÇOKA,ANTON DUKAGJINI,LLUKE BIBI,ABDULLAH MUÇA,ENVER HASA,- me burgim te perjetshem e pune te detyrueshme,humbjen e te drejtave civile e politike dhe konfiskimin e pasuris se lujteshme e te palujteshme ne konformitet me dispozitat ligjore ne fuqi;

3) GJERGJ KOKOSHI,KOL RODHE,NEFAIL SKIKULI,REIS HASHOJA,QEMAL BIÇAKU me tridhjete (30) Vjet burgim,pune te detyrueshme,humbjen e

Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

INFORMACION

# Vendim nr. 5, datë 2.7.1946

Autoret: Gjykata e Lartë Ushtarake

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 1946 |
| STRUKTURA | Gjykata e Lartë Ushtarake |
| DOSJA | Nr. 1081.a.1 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore - gjyqësore |
| SASIA E FLETËVE | 18 |
| VITET EKSTREME | 1946 |
| GJUHA | Shqip |
| BURIMI | AIDSSH |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Njoftim dënimesh dhe konfiskim pasurie

MEDIA FAQE #1



08-590 Prot.

155

Tiranë, 4.VII. 6

Njoftim dënimesh me konfiskim pasurije.-

KOMISIONIT QENDROR PËR KONFISKIMIN E PASURIVE
(Pranë MINISTRIS SË DREJTËSIS)

K ë t u

Për t'u kryer veprimet e duhura të konfiskimit, ju njoftojmë se fajtorët e poshtëshënuar, me vendimin e kësaj Gjykate Nr.5, datë 2 Korrik 1946, përveç ndëshkimeve të tjera, janë dënuar edhe me konfiskimin e pasuris së lujtëshme e të palujtëshme:

1) SAMI ÇERIBASHI, lindur në Gjirokastër, banues në Berat e me qëndresë të përkohëshme në Tiranë;
2) SHABAN BALLA, lindur e banues në Tiranë;
3) QENAN DIBRA, lindur në Dibër e banues në Tiranë;
4) XHAHIT KOKA, lindur në Leskovik, banues në Tiranë;
5) HIVZI GOLJA, lindur në Dibër e banues në Tiranë;
6) ALI KAVAJA, lindur në Kavajë e banues në Tiranë;
7) MEHMETALI BESHIRI, lindur e banues në Tiranë;
8) MAHMUT MËNIKU, lindur e banues në Tiranë;
9) TALAT DRINI, lindur në Dibër e banues në Tiranë;
10) PROF ÇOKA, lindur në Belicë të Strugës e banues në Tiranë;
11) ANTON DUKAGJINI, lindur n'Iballë të Pukës e banues në Tiranë;
12) LLUKË BIBI, lindur në Përmet e banues në [illegible] Korçë;
13) ABDULAH MUÇA, lindur e banues në Tiran[illegible]ë;
14) ENVER HASA, lindur në Dibër e banues në Tiranë;
15) GJERGJ KOKOSHI, lindur në Shkodër e banues në Tiranë;
16) KOLË RODHEJA, lindur e banues në Korçë;
17) NEFAIL SKIKULI, lindur në Dibër e banues në Tiranë;
18) QEMAL BIÇAKU, lindur e banues n'Elbasan;
19) REIS HASHOJA, lindur në Gjirokastër e banues në Tiranë;
20) NESTI OROLLOGAJ, lindur e banues në Korçë;
21) MYRTEZA BELI, lindur e banues në Korçë;
22) MUSINE KOKALARI, lindur n'Adana të Turqis, banuese në Tiranë;

./.

Njoftim dënimesh dhe konfiskim pasurie

INFORMACION

## Njoftim dënimesh dhe konfiskim pasurie

Autoret: Kryetari i Gjykatës së Lartë

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 4.7. 1946 |
| LIDHJA | Vendimi nr. 5, datë 2.7.1946 |
| DOSJA | Nr.1081.a.1 |
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Procesverbal

INFORMACION

## Procesverbal

Autoret: Hetuesia

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 1946 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore-gjyqësore |
| DOSJA | Nr. 1081.A.2 |
| NUMRI I FAQEVE | 2 |
| DATA E KRIJIMIT | 1.4.1946 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

# Procesvebal

MEDIA FAQE #1



------171---

87

hurit që mbrojnë i kanë bërë atribuime njëri-tjatrit gjë që do të shkaktonte ndërlikime, rëndime fajesh dhe konfuzion në rast mbrojtjeje të veçantë. Pas kësaj, Av.Ferid Çabeu këndoi mbrojtjen e përbashkët që na u dorëzua dhe u bashkua me aktet e dosjerit.

Avokat Aristidh Totozani tha: "Jam gati të bëj mbrojtimin e të pandehurve që më janë ngarkuar, me përjashtimin e Gjergj Kokoshit, i cili më ka deklaruar se më çkarkon nga barra e mbrojtjes, mbassi ay don t'a bëjë vet mbrojtimin e tij të fundit para gjyqit."

Pas kësaj, Av.Totozani kënden mbrojtimet e të pandehurve që përfaqëson, të cilat u dorëzuan dhe u bashkuan me aktet e dosjerit.

AV.Efthim Cancoja tha: Jam gati të bëj mbrojtimet e të pandehurve që mbroj. Bashkohem me kolegët e mij Av.ZZ.Çabe,Stringa; Bidoshi e Xhaja në parathënien e mbrojtjes së bërë prej tyre."

Mandej, Av.Canco këndon një nga një mbrojtimet e të pandehurve që përfaqëson, të cilat i dorëzoi dhe u bashkuan me aktet.

Iu dha fjala së pandehurës MUSINE KOKALARI për të bërë mbrojtimin e saj të fundit, e cila, duke e pasur të shkruar, filloi të këndojë mbrojtjen, por iu ndërprè leximi për shkak se kjo mbrojtje, në vend që t'iu përgjegjej dhe t'iu referohej akuzave q'i atribuohen, flet më tepër për grupet t'ashtuquajtura politike dhe për veprimtarinë e vijën e këtyre grupeve. Me gjithë këtë, mbrojtja e së pandehurës u muar dhe u vu ndërmjet akteve të dosjerit.

Mbi pyetjet e bëra, e pandehura përgjegjet: - Kam punuar me Ballin Kombtar. Xhelal Staraveckën s'e kam njohur fare. Në Ballin kam qënë si grup Social-Demokrat. Anëtare e thjeshtë kam qënë unë. Midhat Frashëri ka qënë Kryetar i Ballit Kombtar; kam qënë redaktore e Gazetës "Zën i Liris". Me Suat Asllanin kam pasur vetëm një bisedim e asgjë tjatër. Me Sami Çeribashin, Qenan Dibrën e Shaban Ballën kam pasur vetëm kontakt në mbledhjen për përpilimin e notës. Nuk kemi pasur qëllim të rrëzonim pushtetin me violencë. Nuk kam bashkëpunuar me kriminelat e luftës. Kemi bërë vetëm një notë për shtytjen e zgjedhjeve dhe asgjë tjatër. Pjetër Gilën e kam njohur kur ka ardhur nga Shkodra. Grupi i jonë Social-Demokrat ka qëndruar gjithmonë pasiv."

I pandehuri GJERGJ KOKOSHI, tha: "Nuk e kam sabotuar e tradhëtuar popullin shqiptar kurrë. Po u këndoj mbrojtjen t'ime.

Dhe këndon mbrojtimin e vet.

./.

Procesvebal

INFORMACION

## Procesvebal

Autoret: Procesverbal

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 30 qershor 1946 |
| STRUKTURA | Trupi gjykues i Gjykatës së Lartë Ushtarake: Frederik Nosi, kryetar; Veledin Zejneli dhe Nexhat Hysejni, anëtarë |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Kinema "Nacional", Tiranë |
| LIDHJA | Vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake nr. 5, datë 2.7.1946 |
| GJUHA | Shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Prosesverbale

MEDIA FAQE #1



218

Shtojcë Proces-verbali

Sot më daten 4/ Prill / 1946 diten e Ejte mbasi u pa nevoja u muar ne pyetje e pandehura Musine Kokalari e cila mbasi u pyet deklaroj: Musa Dizdari më ka dërguar vetëm një kart-vizitë me Pjetër Gilën në të cilën shkruhesh se personitqë po dërgoj t'i japësh librin. Mbasi unë e pyeta Pjetrin se çfarë është ky libër, ay më tha se nuk ësht puna për libër por desha të bisedoja për çështjen e opozitës. Këtë njeri unë e njoha për herë të parë dhe i thashë se detyrën që neve patëm për të bërë e bëmë, personi që erdhi tek unë simbas deklaratave të Musajt ishte pse unë njihja më mirë vijën e Partis Social-Demokrate dhe jo se unë isha në lidhje edhe me të tjerët, (mbasi me të tjerët shuhen tre fjalë) mbasi Musaj njihte dhe Programin.

Tjetër gjë nuk kam, thënjet e mija si ma sipër i vërtetoj me nenshkrimin t'im pa ndonje shterngim dhe me vullnet të lirë.

Tirane, më 4/ Prill /1946.

E pandehura: Sekretari: Prokurori:

AIDSSH
Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Prosesverbale

MEDIA FAQE #2



219

SHTOICE PROCESTËVERBALI

Sot me date pese Prill njimije e nendeqind e dyzet e gjashte u muar ne tje Zonjusha Musine Kokalari mbasi u pyet deklaroj si me poshte:-------
Me Suat Asllanin jam njohur qysh prej kohe.Me 'te nuk kam biseduar kure sa i perket anes Politike veçse ne Muajin Nendor te vitit kaluar ne lid me Opoziten.Nga Suat Asllani kam mare libra te ndryshme per te kenduar p.sh.Thomas Mann,Huxlei ete tjera qe nuk me kujtohen.- - - - - - - - - -
Ne muajin nendor nuk e mbaj mend daten me ka ardhur Suat Asllani dhe me thene se do te vinte nji dite per te biseduar dishka.Mbas dy tre ditev Suat Asllani ka ardhur e Mesagjeri dhe me ka folur per te formuar nji o te,njikohesisht duke me shtruar dhe problemin e Opozites,se si do te is mire qe ne Opozite te futeshin gjithe elementat e ndryshme me qellim grumbulloheshin te tere keta rreth opizites se vetme,dhe mbasi te formo kjo Opozite do te gjendeshin elemente adapt per te dale deputet dhe qe te mbronin ne parlament vijen e Opozites.-------------------------
Une keti propozimi iu pergjigja duke i thene:Para se te formohet Opizita het te kini nji program,ay tha se sot per sot nuk eshte e nevojshme per program mbasi neve do te kerkojme nga Qeverija te shtyhen votat,keshtu me vone programin e perpilojme dhe e diskutojme.Une i thashe qe program duhet t'a pozoni mire qe te mos ngjallen konflikte midis elementave te mbulluar nga opozita se perndryshe do te behet nji polemike duke iu lef juve.Ay me tha ne se juve kini nderment te na leftoni atehere neve te t hiqemi,ne kete rast une i thashe:Seicili prej nesh ndjek vijen e vet dh kete juve s'kini perse te terhiqeni.-----------------------------
Te nesermen e kesaj dite ka ardhur perseri Suat Asllani ne Mesagjeri dh tha ne se une kisha ndonji send per te biseduar ne lidhje me Opoziten.Un thashe se para ç'do gjeje duhet te shtrohet programi.Ai me tha se ata k in vendosur qe te paraqesin kerkesen Qeveris simbas parimeve te tyre.Ne lidhje me keto fjale me tha ase eshte nji element qe suvensjonon te holla botimin e nji gazete duke me ftuar ne se une kisha deshire te bashkepun duke shkruar ne gazeten.Keti propozimi iu pergjigja duke i thene se nu mar pjese.- - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - -
Ne lidhje me Opoziten Suat Asllani me ka thene se Gjergj Kokoshin e kis gjetur adapt per Opozite me qe ka qene i njohur si Minister e deputet d si personalitet vet-vetiu i njohur dhe nga Aleatet.Qysh prej ketyre dit me Suat Asllanin nuk jam pare dhe as kam biseduar.----------------------
Me Xhevit Mehillin e njof por nuk kam biseduar gje me 'te.Mbaj mend se zgjedhjeve Xhevit Mehilli me ka thene se kishte per te biseduar diçka m Une i thashe ne se do te me fliste per politike.Ay me tha po,por une i she se tash ç'do gje eshte e kote me qe nuk u pranuam parimisht ne zgje Persa deklaroja me siper mbasi i kendova i vertetoj me firmen t'ime.-----

E PYETURA:

Prosesverbale

INFORMACION

## Prosesverbale

Autoret: Hetuesia

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 4-5 pril 1946 |
| STRUKTURA | Hetuesia |
| DOSJA | Nr. 1081.A.2 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Tiranë |
| LIDHJA | Vendimi nr. 5, datë 2.7.1946 i Gjykatës së Lartë Ushtarake |
| GJUHA | Shqip |
| FAQE | 2 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

# Mbrotja

MEDIA FAQE #1



29/6/46.

224

MBROJTJA

Duke parë zhvillimin e proçesit e shof të arësyshme
të them vetë se i gjithë aktiviteti i atij grupit të vogël
Social-Demokrat nuk është gjë tjetër veçse një notë e
drejtuar aleatëve të perëndimit për shtyrjen e votave
kur qeveria u njoh me të drejtë opozite. Një hap i tillë
nuk do të thotë përmbysje e Pushtetit të sotmë me violencë
se ne, të 37 të pandehurit, në bankën e t'akuzuarve
nuk jemi pjesëtarët e një organizate por antarët e
katër korenteve të ndryshme, tre jashtë Frontit dhe i
katërti i dalë nga gjiri i tij dhe i shkëputur që andej.
Katër korente me konsepte politike-shoqërore të ndrysh-
me dhe vet-vetiu me veprimtari të përshtatura që
pas prirjes që përmban, duke qenë secili përgjegjës
për vehte. Tre të parët nuk kanë patur tjetër
lidhje veçse në dërgimin e një note të përbashkët
për shtyrjen e zgjedhjeve. Koalision nuk do të
thotë shkrirje, as bashkim zoti kryetar po impenjim
moral rreth një programi aktual ose të përhershme
midis partive duke ruajtur e duke qenë vetë përgjegjës
për çështjet e brëndëshme në arritjen e qëllimit ose
idealit, në respektimin ose jo të parimeve që ka
zgjedhur.

Duke qenë në pragun e rindërtimit të vendit
i dalë nga lufta me dëme të mëdha, me plagë të
shumta materiale dhe morale, në pragun e zbati-
mit të reformave shoqërore ku cenohen interesat e
një klase të privilegjuar gjer dje, d.m.th. në përmbys-
jen e një bote feudale drejt ngrehjes të një konsepti
shoqeror demokratik ku baza e jetës është puna
e gjen një pjesë të popullit shqiptar jashtë
Frontit. Gjurma të një të kaluare jo shumë të
largët, nga koha e luftës ku organizata të

Mbrotja

MEDIA FAQE #2



të ndryshme, veç Frontit ishin në këmbë. Konsepte
shoqerore-politike si bazë luftën dimostrative sidomos
me një program demokratik, organizata me fuqi
brutale në duar të nasionalistëve feudale që bënë
një kthesë në rrugën, luftë kundër okupatorit, duke
u hedhur në gjirin e tij. që pati konsekuenca të
hidhura dhe në kurrizin e atyre që shprehnin vetëm
një mendim. Element jashtë Frontit që në një çast
kërkon të shkëputet si pjesë e vogël si çështë nga
gjithë sa e rrethon, duke gjetur një urë kalimi
me anë një korenti demokratik, për të hyrë në
gjirin e një familje demokratike, për të ndjekur
një vijë të vazhdueshme politike, drejt një uniteti
moral të një pakice me shumicën, për ekui-
librimin e ideve dhe divergjencave që në të
vërtetë nuk kanë kundërshtime përsa i përket
reformave shoqerore drejt të cilave po shkojmë
përparo, porse më tepër ftohtësi shpirtrash, konse-
quence e së kaluarës, d.m.th. drejt harmoni-
zimit të një bote mendore rreth një ideali të
përbashkët.

Nga shlirimi i Shqipërisë dhe gjer në njohjen e
qeverisë kaloi një mot kohe. Oscilasione mendimesh,
konfuzion idesh dhe një propagandë e fortë nga
jashtë, sekundiqe mendore duke folur gjithmonë
për elementin jashtë Frontit ku mbretëronte një
gjëndje kaotike. Një mozaik idesh, personash dhe
interesash. Politikë personale, feudalë, kri mi nelo
lufte, kuislinga me një të kaluar të rrije patrio-
tike nëpër malo, tregëtarë të talluar, nëpunës të
përjashtuar, idealista, të cilet, të gjithë po për-
jashtim trumbetojnë idealizma-nasionalizma
demokrasi. Element 80% i interesuar për interesa

Mbrotja

MEDIA FAQE #3



225

private që bëhen heronj, nasionalistë dhe që mbajnë shtrënguar 20% të elementit idealist, i cili lëkundet mbasi s'ka një vijë të qartë politike dhe që vihet në lëvizje nga rrethanat e kohës duke u bërë mburojë e atyre që kërkojnë të luajnë prapa skenës, nga brenda dhe nga jashtë. Propaganda e shëndoshë e tumbetuar për rezistencë që i vë të rinjtë në lëvizje, të cilët duke mos patur një kriter të shëndoshë ideologjije, të udhëhequr vetëm me fjalën nasionalizmë të thatë të cilët duke mos kuptuar se lufta që i bëhet Ballit ose Legalitetit është luftë kundër një vije politike kompromisi ose konsepti shqiptar feudal, më vend që t'i afrojë i largon pa ditur as atyvetë duke menduar se luftohen ose nuk i duan, të luajnë si ... në gjirin e Frontit se s'u bënë dot dhe mbetet jashtë. Ahere një tentativë po bëhet dhe ka efekt, duke u-shkëputur andaj nga janë secila vetëm atëhere kur i gjithë elementi jashtë Frontit të jetë vënë në lëvizje dhe kur e gjithë prapa skena të jetë vënë në pa mundësi të bëjë gjë dhe në goftësa ka ndërmend dhe me gojë nuk e efengj, kur propaganda aleate të mos ketë më efekt me një qëndrim zyrtar të prerë duke mos udhëhequr shpresë, në çastin e demaskimit për t'u deftuer për të mirë a për të keq, ashtu si është me të vërtetë. Atëkohë kur e vërteta e mumurifjena do të dali në dritë, ku interesat zvishen me petkun e idealizmit, vetëm atëhere ata do të shkëputen prej tyre dhe duke i luftuar ata me anën e një korenti, si bazë patriotizmin demokratik për zbërthimin e problemave shqiptare të zërë vënd në gjirin e Frontit, si tendencë e së majtës siç e përmendëm anti-fashist.

Mbrotja

MEDIA FAQE #4



Me njohjen e qeverisë me të drejtë opozite, me stabilitetin e gjëndjes 95%, në çastin kur elementi ishte vënë në lëvizje dhe kërkonte të dilte në skenë, ky grup i vogël e gjeti të përshtatshëm momentin e shkëputjes dhe me qënë se nga lija do dilesh në dritë e gjeti t'arësyeshëm që notën ta bënte të përbashkët duke e ndarë elementin jashtë Frontit në tendenca të ndryshme demokratike, duke u-angazhuar të gjithë rreth një programi aktual të përbashkët dhe përputhesh me atë të Frontit, duke mujtur gjithësekush programet shqiptare, strukturën e brendëshme dhe mënyrën e aktivitetit kur të shtyhe. shin votat. Në çastin e parë të fillonte lufta në mos respektimin e atij programi, duke u-shkëputur dhe në një kohë e sipër duke luftuar edhe çdo tendencë që mund të vinte nga kërndo Frontit për tu lidhur me nasionalistët e jashtëm ose çdo formë bllokimi në ndarjen e kampeve më dysh, po në shpërndarjen e elementave 80% dhe shqiptar atë 20%, duke vajtur tendencat e majta nga një anë kundër atyre të së djathtës.

Për këtë u-hartua nota e përbashkët duke u-drejtuar aleatëve, që qëndrimi i tyre zyrtar të kthjellonte qëllimet duke mos luajtur mbi skenë ose heshtja negative të priste lëvizjen e atij zjarri të ndezur që kërkojnë të mbulohet, duke mos u-bërë aqëllimë asnjë element që po dështuar edhe moralisht të presi andej. Për të shpëtuar kështu një herë e mirë influencës së propagandës së jashtme.

I drejtohem trupit gjykues, me respekt që ta shqyrtojë edhe një herë përsa i përket aktivitetit t'im dhe në rast se rezultoi e kundërta përsa i përket qëllimeve të sipër hequra prandaj me kënaqësi edhe dënimin më të rëndë.

Mbrotja

INFORMACION

## Mbrotja

Autoret: Musine Kokalari

TRANSKRIPT

Mbrojtja
Duke parë zhvillimin e proçesit, e shof të arsyeshme të them vetë se i gjithë aktiviteti i atij grupi të vogël Social-Demokrat nuk është gjë tjetër veçse një notë e drejtuar aleatëve të perëndimit për shtymjen e votave kur qeveria u njoh me të drejtë opozite. Një hap i tillë nuk do të thotë përmbysje e pushtetit të sotëm me violencë, se ne, të 37 të pandehurit, në bankën e të akuzuarve, nuk jemi pjesëtarët e një organizate, por antarët e katër korenteve të ndryshme, tre jashtë frontit dhe i katërti i dalë nga gjiri i tij dhe i shlëputur qandej. Katër korente me koncepte politike-shoqërore të ndryshme dhe vet-vetiu me veprimtari të përshtatura që pas frymës që përmban, duke qenë secili përgjegjës për vehte. Tre të parët nuk kanë pasur tjetër lidhje veçse në dërgimin e një note të përbashkët për shtymjen e zgjedhjeve. Koalicion nuk do të thotë shkrirje, as bashkim, zoti kryetar, po impenjimi moral rreth një programi aktual ose të përhershëm midis partive, duke ruajtur e duke qenë vetë përgjegjës për çështjet e brëndshme në arritjen e qëllimit ose të idealit, në respektimin ose jo të parimeve që ka zgjedhur.
Duke qënë në pragun e rindërtimit të vëndit, i dalë nga lufta me dëme të mëdha, me plagë të shumta materiale dhe morale, në pragun e zbatimit të reformave shoqërore, ku cënohen interesat e një klase të privilegjuar gjer dje, d.m.th. në përmbysjen e një bote feudale drejt ngrehjes së një koncepti shoqëror demokratik, ku baza e jetës është puna, e gjen një pjesë të popullit shqiptar jashtë Frontit. Gjurma të një të kaluare jo shumë të largët, nga koha e luftës ku organizata të ndryshme, veç Frontit, ishin në këmbë. Koncepte shoqërore-politike si bazë luftën dimostrative, ndonëse me një program demokratik, organizata me fuqi brutale në duar të nacionalistëve feudalë, e bënë një kthesë në rrugën, luftë kundër okupatorit, duke u hedhur në gjirin e tij, që pati konseguenca të hidhura edhe në kurrizin e atyre që shprehnin vetëm një mendim. Elementë jashtë Frontit, që në një çast kërkon të shkëputet si pjesë e vogël, siç është nga gjithë sa e rrethon, duke gjetur një urë kalimi me anën e një korenti demokratik, për të hyrë në gjirin një familje demokratike, për të ndjekur një vijë të vazhdueshme politike, drejt një uniteti moral të një pakice me shumicën, për ekuilibrimin e ideve dhe divergjencave, që në të vërtetë kanë kundërshtime përsa i përket reformave shoqërore drejt të cilave po shkojmë përpara, porse më tepër ftohtësi shpirtrash, konseguencë e së kaluarës, d.m.th. drejt harmonizimit të një bote mendore rreth një ideali të përbashkët.
Nga shlirimi i Shqipërisë dhe gjer në njohjen e qeverisë kaloi një mot kohë. Oscilasione mendimesh, konfuzion idesh dhe një propagandë e fortë nga jashtë. Lëkundje mendore, duke folur gjithmonë për elementin jashtë Frontit, ku mbretëronte një gjëndje kaotike. Një mozaik idesh, personash dhe interesash. Politikë personale, feudale, kriminelë lufte, kuislingë me një të kaluar të mirë nëpër male, tregtarë të tatuar, nënpunës të përjashtuar, idealistë, të cilët, të gjithë pa përjashtim të trumbetojnë idealizmë-nacionalizme-demokraci. Elementë të interesuar 80% për interesa private që bëhen heronj, nacionalistë dhe që mbajnë të shtrënguar 20% të elementit idealist i cili lëkundet mbase se ka një vijë të qartë politike dhe që vihet në lëvizje nga rrethanat e kohës, duke u bërë mburojë e atyre që kërkojnë të lozin prapa skenës, nga brenda dhe nga jashtë. Propaganda e shëndoshë e trumbetuar për rezistencë, që i vë të rinjtë në lëvizje, të cilët duke mos pasur një kriter të shëndoshë deologjije, të ushqyer vetëm me fjalën nacionalizëm të thatë, të cilët duke mos kuptuar se lufta që i bëhet Ballit ose Legalitetit është luftë kundër një vije politike kompromisi ose koncepti shoqëror feudal, në vend që t'i afrojë, i largon pa ditur as ai vetë, duke menduar se luftohen ose nuk i duan. Të hyjnë si numër në gjirin e Frontit se kanë bërë dot, dhe mbeten jashtë. Ahere një tentativë që bëhet dhe ka efekt, duke u shkëputur andej nga janë, vetëm atëherë kur i gjithë elementi jashtë Frontit të jetë vënë në lëvizje dhe kur gjithë prapaskena të jetë vënë në pamundësi të bëjë gjë dhe në qoftë se ka ndërmend dhe me gojë nuk e çfaq, kur propoganda aleate të mos ketë më efekt me një qëndrim zyrtar të prerë, duke mos ushqyer shpresa, në çastin e demaskimit për t'u dëftyer për të mirë a për të keq, ashtu siç është në të vërtetë. Atë kohë kur e vërteta e murmuritjeve do të dalë në dritë, ku interesat zhvishen me petkun e idealizmit, vetëm atëhere do të shkëputen prej tyre dhe duke i luftuar ato me anën e një korenti; si bazë patriotizmin demokratik për zbarthimin e problemeve shoqërore të ri në vend në gjirin e Frontit, si tendencë e së majtës, siç e premton emri antifashist.
Me njohjen e qeverisë me të drejtë opozite, me stabilitetin e gjendjes 95% në çastin kur elementi ishte vënë në lëvizje

MEDIA #8

# Kërkesë

MEDIA FAQE #1



Gjykatës së Lartë Ushtarake

Tiranë

Nr. 680 29-5-57

Unë, e nënshkruara Musine Kokalari, e bija e Reshatit dhe e Hanushesë, me profesion librare, arestuar nga Mbrojtja Popullore në rrugën Dervish Hima më 23 Janar 1946, dënuar nga Gjykata e Lartë Ushtarake me 20 vjet privim lirie, me qënë se kam plotësuar gjysmën e dënimit, paraqis kërkesën për lirim me kusht.

Me qënë se aktiviteti im është bërë para zgjedhjeve të 2 Dhjetorit 1945, gjatë periudhës kur Partia e kish lënë veten në gjysmë ilegalitet dhe roli i saj në Front nuk ishte i hapët, Qeverisë nuk i jepej ngjyra e vërtetë që ishte komuniste dhe direktivat e Komitetit Qëndror ndaj Partisë për mos tolerimin e krijimit të partive të tjera borgjeze nuk ishin shpallur zyrtarisht, besoj se kërkesa ime do merret parasysh.

Shpresoj se kjo çështje do të shihet jo nënë influencën e një anësh[m]erisë ideologjike, as nënë pretekstin e njëkut me qëndrim, po nënë prizmin e gjykimit që ushtron ligji për veprimtarinë e kryer në kohë e kondita të ndryshme duke balancuar drejt kushtet e të dy palëve e që një lëshim i kondicionuar të jetë një koherësi [illegible] i garantuar po nga forca e ligjit, në përputhje vetëm të qëndrimit korekt brendo, që i tillë do jetë dhe i jashtë, duke mos patur asnjë anë tjetër lehtësonjëse ku mund të mbështetem.

Mbetem me nderime
Musine Kokalari

Kamp, 22/V/1957.

[illegible]
[illegible] Kolegji Ushtarak.
23-V-957 [illegible]

Kërkesë

INFORMACION

## Kërkesë

Autoret: Musine Kokalari

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 22.5.1957 |
| DOSJA | Nr. 1081.a.2 |
| SASIA E FLETËVE | 297 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore-gjyqësore |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Përgjigje

MEDIA FAQE #1



222

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE MBRENDESHME
DREJTORIJA E PUNEVE MBRENDESHME
" Ana e sigurimit shtetit "
Nr. 2259

" S E K R E T "

Tirane, me 29 /VIII/1957.-

L A N D A : Mbi te denuaren Musine Reshat Kokolarin.

GJYKATES SE NALTE
(Kolegjit Ushtarak)

T I R A N E .

Gjegje shkreses tuaj Nr.122 date 31/VII/1957.

Sa kerkoni me te sipermen, ju njoftojme se e permendura ne lende gjate vuajtjes se denimit nuk ka mbajtur qendrim te mire, ne menyre shume te holle dhe te rafinuar ka zhvilluar agjitasion e prapagande kundra Pushtetit popullor, ka tentuar disa here qe te grumbullonte rreth vetes vajza te reja te denuara per faje ordinere, por nuk ja ka arijtur qellimit pse eshte demaskuare dhe goditur per keto veprime.-Ka prapaganduar duke bere krahasimin e burgjeve tona, duke thene se ne brugjet tona njerezit me kurajo civile ju mbyetet inisiativa dhe te drejtat e tjera qe gezojne te burgosurit etj.-Rin vazhdimishte me elementa armiq te Pushtetit popullor, ne punen qe ben nuk tregohet e penduar aspak per krimin e kryer, prandaj ne duke u bazuare sa me siper, nuk jemi te mendimit qe te lirohet me kusht

Zv.DREJTORI PUNEVE MBRENDESHME
N/K O L O N E L
(Kadri Hazbiu)

Përgjigje

INFORMACION

## Përgjigje

Autoret: Drejtoria e Punëve të Brendshme

| | |
|---|---|
| DOSJA | Nr. 1081.A.2 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | E perfunduar, hetimore-gjyqësore |
| STRUKTURA | Drejtoria e Punëve të Brendshme, Ana e Sigurimit të Shtetit |
| NR. I FLETEVE | 1 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Tiranë |
| GJUHA | Shqip |
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 29.8.1957 |

| | |
|---|---|
| LIDHJA | Kërkesë e Musine Kokalarit drejtuar Gjykatës së Lartë Ushtarake |
| BURIMI | AIDSSH |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #10

# Vendim

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
"Kolegji Ushtarak"

Nr.-41 i Radhorit Themeltar.-
Nr.-41 i Vendimit.-

V E N D I M
"N'EMËR TË POPULLIT"

Këshilli Gjyqësor i Kolegjit Ushtarak të Gjykates së Lartë i formuar nën kryesinë e:

N/Kolonel Loni Dimoshit Antar i Gjykates së Lartë,me anta[...]
N/Kolonel Sotir Spiron -"- -"- -"-
M a j o r Hilmi Telegrafin -"- -"- -"-

me asistimin e kryesekretarit N/Toger Emin Hoxha dhe me pjesmarrjen e Prokurorit N/Kolonel Faik Minarollit,në seancë gjyqësore me dyer të hapura më daten 14/XII/1957 mori në shqyrtim çështjen për lirim para koh[e] me kusht të të dënuarës MUSINE RESHAT KOKALARI, e bija e Reshatit dhe [e] Hanushes,e date lindjes 1918,lindur në Adona të Turqisë dhe banues në Tirane,me arsim të lartë,me profesion libmare,e pa martuarë,e pa dënua[r] e arrestuarë më 23/I/1946 dhe e dënuarë me vendimin Nr.5 date 2/7/1946 të ish Gjykates së Lartë Ushtarake në bazë të neneve 3;15 e 18 të ligj[ës] Nr.41 date 14/I/1945 për krime kundër shtetit,përfundimisht me 20 vjet burgim,konfiskimin e pasurisë dhe me humbjen e të drejtës elektorale p[ër] 5 vjet kohë.-

Edënuasa Musine Kokalari,me kërkesën e saj date 22/V/1957 i ësh[të] drejtuar Kolegjit Ushtarak të Gjykates së Lartë për lirim para kohe m[e] kusht,mbasi ka plotësuar të gjitha kanditat e kërkuara nga ligja.-

Këshilli Gjyqësor,mbasi shqyrtoj çështjen në tërësi,mbasi dëgjo[i] fjalën e Prokurorit N/Kolonel Faik Minarollit,i cili kërkoj refuzimin e kërkesës për lirim parakohe me kusht të të dënuarës Musine Kokalari,

V E R E N

E dënuara Musine Kokalari ka vuajtur më shumë se gjysmën e mas[ës] së dënimit,kështu që ajo ka plotësuar vetëm një nga kanditat që kërkon neni 354 i K.Pr.P.për lirimin para kohe me kusht.

./.

Nr. 67 Prot Date 29.01.2026 AIDSSH

Vendim

MEDIA FAQE #2



— 2 —

Si mbas nenit 57 të K.P.,lirimi para kohe me kusht mund të jepet kur i dënuari ka treguar me sjelljet dhe punën e tij se është përmirësuar.Nga të dhënat e organeve të Punve të Mbrendeshme ku ë dënuara vuan dënimin,rezulton se ajo nuk mbanq qëndrim të mirë dhe nuk është penduar për krimet e kryera,kështu që ajo nuk ka plotësuar kanditat kryesore që kërkon neni 57 i K.P.për lirim para kohe me kusht?

PËR KËTO ARËSYE

Këshilli Gjyqësor i Kolegjit Ushtarak të Gjykates së Lartë në mbështetje të nenit 361 të K.Pr.P.

'V E N D O S I

Refuzimin e kërkesës për lirimin para kohe me kusht të të dënuarës MUSINE RESHAT KOKALARI.

Ky vendim është i formës së prerë.

U shpall në Tirane më 14/XII/1957.

| A N T A R | A N T A R | K R Y E S U S I |
| --- | --- | --- |
| (Hilmi Telegrafi)d.v. | (Sotir Spiro) d.v. | (Loni Dimoshi)d.v. |

Vërtetohet se është baras me origninalin
Kryesekretar'i Gjykates së Lartë
N/Toger( Emin Hoxha )

Nr. 67 Prot Date 29.01.2026 AIDSSH

Vendim

INFORMACION

## Vendim

Autoret: Kolegji ushtarak i Gjykatës së Lartë

| | |
|---|---|
| DOSJA | Nr. 1081.A.2 |
| STRUKTURA | Gjykata e Lartë, kolegji ushtarak |
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 14.12.1957 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Tiranë |
| LIDHJA | Kërkesa e Musine Kokalarit |
| GJUHA | Shqip |
| BURIMI | AIDSSH arkivi i ish-Sigurimit të Shtetit |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Foto

MEDIA FAQE #1



Foto

MEDIA FAQE #2



Foto

INFORMACION

## Foto

| | |
|---|---|
| DOSJA | Nr. 1081.A.2 |
| SASIA E FLETËVE | 297 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Tiranë |
| VITET EKSTREME | 1945, 1946 |
| TIPOLOGJIA E DOSJE | Hetimore-gjyqësore |
| BURIMI | AIDSSH |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.